



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:283800

Datë: 28.03.2023

Numri i dokumentit: 04129749

2021:283801

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Y.M.R. nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.35/23, të datës 10.3.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit Y.M.R., në njërën anë dhe të dëmtuarit N.N.A., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1874/21, të datës 16.12.2021, për shkak të veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 20.3.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja ND.nr../23, të datës 10.3.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit Y.M.R. nga Ferizaj, rruga “.....”, banesat....., ... i lindur me dt....., me nr. personal, në njërën anë dhe të dëmtuarit N.N.A. nga Ferizaj, rruga “...” pa nr. në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 1874/21, të datës 16.12.2021 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit Y.M.R., për shkak të veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 1874/21, të datës 16.12.2021, e ka akuzuar të pandehurin për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt.07.3.2023, konform nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 10.3.2023 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja ND.nr..../23, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 20.3.2023, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL
2021:283801, me dt.20.03.2023.**

Zyrtare ligjore,
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tre/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.